

Ftesë për Ofertë

Thirrje për ofertë me objekt:

Rehabilitim dhe Mobilim i Qendrës për Mirëqenie Psikosociale, Bashkia Kukës.

Nr. ALB/25/TIR/66/CP

Informacion i përgjithshëm mbi organizatën

Terre des hommes (Tdh) Misioni në Shqipëri është një organizatë jofitimprurëse që operon për mbi 30 vjet në fushën e të drejtave të fëmijëve dhe mbrojtjes së fëmijëve, duke qenë ndër kontribuuesit kryesorë në ngritjen dhe forcimin e një sistemi kombëtar për mbrojtjen e fëmijëve në Shqipëri. Tdh Shqipëri po zbaton programe në fushën e migracionit dhe antitrafikimit, mbrojtjes së fëmijëve dhe aksesit në drejtësi. Tdh Shqipëri punon në partneritet të ngushtë me aktorë kombëtarë dhe vendorë në advokimin, forcimin e sistemit dhe zbatimin e modeleve të shërbimeve, qasjeve dhe nismave që synojnë të përmirësojnë mirëqenien e fëmijëve, të rinjve dhe familjeve në nevojë.

Informacion i përgjithshëm mbi projektin.

Terre des hommes – Misioni në Shqipëri në partneritet me Bashkinë Kukës janë duke zbatuar projektin “Zhvillimi i Shërbimeve të Specializuara – Qendra Multifunkionale për Mirëqenie Psikosociale Kukës”, si pjesë e programit #EU4SocialCare, financuar nga Bashkimi Evropian në Shqipëri, zbatuar nga UNICEF Albania dhe World Vision Albania, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Ky projekt synon krijimin e një mjedisi të përshtatshëm dhe të specializuar për ofrimin e shërbimeve psikosociale për fëmijët, të rinjtë, prindërit/kujdestarët dhe grupet në nevojë të ekspozuar ndaj traumës, krizave apo situatave të vështira dhe të papritura. Përmes tij synohet të përmirësohet aksesit në mbështetjen për shëndetin mendor, duke nxitur qëndrueshmërinë dhe procesin e rimëkëmbjes. Qendra për Mirëqenie Psikosociale në Kukës përfaqëson një nismë inovative, që synon të adresojë boshllëqet kritike në ofrimin e mbështetjes psikosociale dhe shërbime të specializuara brenda Bashkisë Kukës. Qendra do të ofrojë një gamë të integruar shërbimesh të ndërhyrjes së hershme, këshillimit individual dhe në grup, ndërhyrjes në krizë dhe edukimit komunitar. Projekti do të vendosë një sistem të koordinuar kujdesi, i cili përfshin menaxhimin e rasteve dhe një mekanizëm referimi. Kjo siguron që përfituesit të lidhen në mënyrë të shpejtë me shërbimet përkatëse të shëndetit mendor, duke thjeshtuar aksesin dhe përmirësuar rezultatet.

Projekti konsiston në zhvillimin dhe përshtatjen e një hapësire të dedikuar brenda një objekti në pronësi të Bashkisë Kukës, me qëllim krijimin e Qendrës për Mirëqenie Psikosociale. Në përputhje me marrëveshjen e partneritetit të nënshkruar ndërmjet Bashkisë Kukës dhe Terre des hommes, kjo qendër do të vendoset në katin e parë të godinës së rikualifikuar të ish-Shtëpisë së Oficerëve, aktualisht e përdorur nga Sektori i Shërbimeve Sociale, ku operojnë specialistët e ndihmës ekonomike dhe të pagesave të paaftësisë. Hapësira e vënë në dispozicion do të përshtatet sipas nevojave funksionale dhe kërkesave teknike për zhvillimin e aktiviteteve psikosociale, duke garantuar kushte të përshtatshme për ofrimin e shërbimeve komunitare dhe mbështetëse.

1. Përshkrimi i punës

Në kuadër të zbatimit të këtij projekti, Terre des hommes – Misioni në Shqipëri kërkon një kontraktor të licensuar për realizimin e **punimeve rehabilituese dhe mobiluese** në hapësirat e përcaktuara në katin e parë të objektit të ish-Shtëpisë së Oficerëve në Kukës. Ndërhyrja do të bazohet në relacionin teknik të përgatitur nga strukturat përkatëse të Bashkisë Kukës dhe ka për qëllim përshtatjen arkitektonike dhe funksionale të ambienteve për ofrimin e shërbimeve psikosociale për fëmijë, të rinj dhe familjarë të tyre,

Objektivat kryesore të ndërhyrjes:

- Përshtatja e ambienteve ekzistuese për të përmbushur kërkesat funksionale dhe teknike të shërbimeve për mirëqenie psikosociale, në përputhje me standardet e aksesueshmërisë.
- Sigurimi i ndriçimit natyral dhe artificial adekuat, në funksion të hapësirave për këshillim individual dhe në grup, ndihmës së parë psikologjike, shërbimeve ndërgjegjëse komunitare dhe punës administrative.
- Mobilimi i brendshëm me pajisje funksionale dhe ergonomike, për të garantuar komoditet dhe efikasitet në ofrimin e shërbimeve.
- Përmirësimi i kushteve të mikroklimës së brendshme përmes instalimit të sistemeve të kondicionimit dhe shtrimit me materiale rezistente dhe higjienike.
- Krijimi i një ambienti të ngrohtë, mikpritës dhe terapeutik, që kontribuon në reduktimin e stresit dhe në përforcimin e ndjesisë së sigurisë dhe mirëqenies për përfituesit.

Kontraktori i përzgjedhur do të jetë përgjegjës për realizimin e punimeve në përputhje me dokumentacionin teknik të dorëzuar, standardet e cilësisë të kërkuara dhe afatet e përcaktuara në kontratë.

Vini re! Në varësi të objektit të aktivitetit tuaj si edhe interesit për tu përfshirë në këtë thirrje, ju mund të aplikoni për të dy lotet sipas preventivit (rehabilitim dhe mobilim) ose për njërin prej tyre (rehabilitim ose mobilim).

2. Subjektet më të drejte aplikimi

Të gjitha kompanitë e regjistruara dhe të licensuara me objekt aktiviteti ne përputhje me objektin e kësaj thirrje dhe që janë në përputhje me paragrafin 1 kanë të drejtë të shprehin interesin e tyre për të marrë pjesë në këtë thirrje për tender. Palët e interesuara duhet të jenë në gjendje të ofrojnë një faturë të fiskalizuar në zbatim të Ligjin Nr. 87/2019, datë 18.12.2019 "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit" në përputhje me situacionin e punimeve të kryera prej tyre.

Kompanitë e interesuara kanë mundësinë të caktojnë një takim për të vizituar vendin dhe për të shqyrtuar punën e nevojshme për t'u kryer, për të lehtësuar përgatitjen e ofertës së tyre financiare.

3. Shprehje e interesit

Të gjitha kompanitë e interesuara për të marrë pjesë në këtë procedure prokurimi janë të lutura që të dërgojnë ofertat e tyre ekonomike dhe teknike në adresën: alb.application@tdh.org ose të dërgojnë ato në zarf të mbyllur, me numrin e tenderit " **ALB/25/TIR/66/CP**" të shënuar në pjesën lart-djathas dhe të dërgohet në: Zyrat e Terre des hommes në Tiranë, Shqipëri: Adresa: Rruga "Skënderbej", Nd. 6 H. 2, AP. 17 & 18, Tirana, Albania, para datës 09.06.2025, ora 12:00.

Për të vizituar vendin e kryerjes së punimeve duhet që kërkesën t'a dergojnë në të njejtën adresë elektronike, deri më 30.05.2025.

Që një ofertë të jetë e vlefshme, ajo duhet të përmbajë minimalisht këto informacione:

- 1) Certifikatën e regjistrimi të biznesit.
- 2) Licensë për ushtrim të aktivitetit.
- 3) Vërtetim shlyerje detyrimesh.
- 4) Informacion për kompaninë duke përfshirë punët paraprake të kompanisë (CV e kompanisë, puna e mëparshme me OJF do të ishte një plus)
- 5) Çmimin final duke përfshirë të gjitha kostot (materialet, puna, pajisjet) pa dhe me TVSH.
- 6) Afatin e realizimit të punimeve.
- 7) Kushtet e pagesës.

4. Kriteret e përzgjedhjes:

Propozimet e marra do të vlerësohen nga një komision i brendshëm i cili do të vendosë për përzgjedhjen e kompanisë fituese bazuar në kriteret e mëposhtme në rendin e listuar:

- 1) Kostoja totale (Oferta financiare)
- 2) Specializimi në lidhje me detyrat
- 3) Afati kohor i dorëzimit të punimeve
- 4) Kushtet e pagesës
- 5) Eksperience e mëparshme me OJF

5. Angazhimi

Kushtet e bashkëpunimit me kontraktorin e përzgjedhur do të rregullohen me anë të një marrëveshjeje kuadër që duhet të nënshkruhet përpara se të kryhet çdo punim dhe/ose transaksion financiar.

Para nënshkrimit të kontratës kompania kontraktuese e përzgjedhur do t'i nënshtrohet procesit të vetingut (hetimit), për t'u siguruar që nuk është e lidhur në asnjë formë të aktivitetit kriminal.

Kontraktori i përzgjedhur duhet të nënshkruajë politikat e brendshme të Tdh si mëposhtë:

- 1) Politikën Anti-Mashtim/Korrupsion dhe konfliktit të interesit
- 2) Praktikat e mira të biznesit
- 3) Kodin Global të Sjelljes
- 4) Politikat për mbrojtjen e fëmijëve nga shfrytëzimi dhe abuzimi seksual (PSEA),

6. Dorëzimi i punëve

Të gjitha punimet duhet të dorëzohen plotësisht para datës 20.07.2025 .